



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017 Ref.: 542/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2022:
  - Antropologji, BA, 180 ECTS, (me specializim në: Antropologji Kulturore; Arkeologji), maksimumi 40 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Integritime Evropiane dhe Administratë Publike, MA, 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filozofik që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filozofik që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Integrimë Evropiane dhe Administratë Publike, MA, 120 ECTS, dhe Antropologji, BA, 180 ECTS me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Integrimë Evropiane dhe Administratë Publike	MA	120	Agim Zogaj, Arben Hajrullahu, dhe Zenun Halili
2	Antropologji	BA	180	Albina Drançolli, Kujtime Boshtrakaj, dhe Arsim Sinani

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin Filozofik më 23.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Stephen Adam dhe Vjekoslav Afrić.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Filozofik, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Filozofik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë